

SHOQERIA

“DHIMA” Sh.p.k

Adresa: ndertese 3 kateshe, kati I-re, prane restorant Karaj, Lanabrgesa, Dajt Tirane Tel: 0682090472

Nr. _____ Prot

Date ____/____/2018

Lenda: Kerkese per terheqjen e formularit te konsultimit me publikun

Drejtuar: AGJENCISE KOMBETARE TE MJEDISIT

TIRANE

Une i nenshkruari, *Arsen Osmanllari*, perfaqesues ligjor i shoqerise “DHIMA” Sh.p.k., regjistruara prane Qendres Kombetare te Biznesit, me NUIS: J71328010N, dhe me seli ne adresen: Lanabregsa, Dajt, Tirane, ne kuader te organizimit te Konsultimit me publikun, ne lidhje me **Raportin e Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis** te aktivitetit qe kryen subjekti jone, bej kete kerkese per terheqje te formularit tip kerkese, bazuar ne V.K.M. Nr. 247, date: 30.04.2014, “Per percaktimin e rregullave, te kerkesave e te procedurave per informimin dhe perfshirjen e publikut ne vendimarrjen mjedisore” dhe Urdherit Nr. 78, date 14.05.2014 te Drejtorit te Pergjithshem te A.K.M-se.

Me poshte gjeni te dhena lidhur me shoqerine dhe aktivitetin qe ajo kryen:

- Subjekti: “DHIMA” Sh.p.k.
- Perfaqesuesi: Arsen Osmanllari
- Aktiviteti: Prodhim dhe ambalazhim uji mineral natyral
- Vendodhja: Lanabregas, Dajt, Tirane

Duke Ju falenderuar per bashkepunimin.

Kerkuesi

1. Informacionin ne lidhje me kerkesen dhe llojin e Lejes Mjedisore qe duhet te pajiset ky aktivitet

Referuar Ligjit Nr.10448, date 14.07.2011 "Per lejet e mjedisit", i ndyshuar me ligjin Nr.60/2014, shtojca 1,

- ID 7.7 - Prodhim i ushqimeve dhe pijeve dhe veprimtarite e lidhura me to.
- pika g) Prodhim dhe ambalazhim i pijeve joalkoolike

Referuar procesit teknologjik te prodhimit dhe te ambalazhimit te ujit mineral natyral, kjo veprimtari perfshihen ne pikat 7.7. g)

Kapaciteti kufi: Referuar ligjit per kete lloj veprimtarie nuk ka kapacitet kufi por aplikohet Leje Mjedisore e Tipit B per te gjitha keto lloj instalimesh.

Linja e ambalazhimit te ujit ka nje kapacitet prej _____.

Per sa me siper trajtuam, Leja Mjedisore qe duhet pajiset kjo veprimtari duhet te jete LEJE MJEDISORE – Tipi "B".

2. Te dhena te ekstraktit te leshuar nga QKR

Sipas Ekstraktit te regjistrit tregtar te leshuar nga QKR, po japim me poshte te dhenat e subjektit:

NUIS:	J71328010N
Data e Rregjistrimit:	15.03.1995
Emri i Subjektit:	"DHIMA" Sh.p.k.
Selia e shoqerise:	Lanabregas, Dajt, Tirane.
Administrator:	Arsen Osmanllari
Ortaket:	Arsen Osmanllari, zoteron 100% te aksioneve

Objekti i aktivitetit: Prodhim i ujit te ambalazhuar mineral natyral
Bashkelidhur do te gjeni nje kopje origjinale te Ekstraktit te Regjistrit Tregtar te Leshuar nga QKR.

3. Adresa e Vendndodhjes se instalimit

Fabrika eshte e vendosur ne lindje te Tiranes be zonene e malit te Dajtit rreth 25 m nga rruga kryesore automobilistike Dajt. Territori perreth eshte kryessht i pjerret, ndersa fabrika ngrihet mbi nje siperfaqe te sheshte.

4. Pershkrim i veprimtarise qe parashikohet te zhvillohet ne instalim

PRODHIMI I UJIT AMBALAZHUAR

Ujërat natyrore për nga vetë natyra e formimit të tyre si dhe nga zona gjeologjike që ato përshkojnë, janë ujëra me përmbajtje më të lartë ose më të ulët kripërash, si dhe papastërti të tjera fizike e kimike. Çdo industri qoftë energjitike, termike, ushqimore apo industriale ka kërkesa të caktuara për cilësinë dhe pastërtinë e ujit. Prandaj ujërat natyrore i nënshtrohen përpunimeve të ndryshme në mënyrë që ato të arrijnë kërkesat më shumë ose më pak rigoroze që shtron secila industri. Krahas metodave të zakonshme të kullimit, sedimentimit, filtrimit dhe metodave të pastrimit fizik të ujit, ujërat i nënshtrohen proceseve të përpunimit kimik me gëlqere ose e kombinuar me gëlqere dhe xhele hekuri ose alumini; proceseve të jonokëmbimit (Na-kationit, H-kationit, OH- anionit etj) si dhe metodave të ç'kripëzimit të plotë me osmozë inverse apo me elektro-osmozë inverse etj.

Në funksion të cilësisë së ujit që kërkohet dhe të natyrës së ujit si lëndë e parë që disponohet, përzgjidhen dhe metodat e përpunimit dhe ç'kripëzimit të ujit.

4.1. Perberja ujrave natyrore.

-Jonet e kalciumit zënë vendin e parë për sa i përket sasisë në ujërave natyrore pak të mineralizuar. Si burim kryesor i përmbajtjes së këtyre joneve në ujërat natyrore janë kontaktet e tij me shkëmbenjtë gëlqerore, të përbëra nga karbonati kalciumit, CaCO_3 , të cilat treten nga prania në ujë e gazit karbonik. Tjetër burim i joneve Ca^{2+} në ujërat natyrore janë shkëmbenjtë prej gipsi $\text{CaSO}_4 \cdot 2\text{H}_2\text{O}$

-Jonet e magnezit, vijnë në ujë nëpërmjet tretjes së dolomiteve MgCO_3 , CaCO_3 me rritjen e sasisë së CO_2 në ujë. Me zgjatjen e mineralizimit, në ujrata natyrore ulet përmbajtja e joneve Ca^{2+} , sepse CaCO_3 dhe CaSO_4 me rritjen e përqëndrimit dhe me avullimin e ujit, kalojnë në fazë të ngurtë dhe për shkak të tretshmërisë së vogël në ujë, ato ndahen në mënyrë të pandërprerë nga solucionet. Si rezultat i tretshmërisë më të mirë të MgCO_3 dhe MgSO_4 , jonet Mg^{2+} e rrisin përqëndrimin në ujërat natyrore dhe arrijnë në ujrata e mineralizuar deri në disa gram për litër.

Prej joneve të metaleve alkaline në ujërat natyrore në sasi më të madhe përmban *jone natrium*, dhe me rritjen e shkallës së mineralizimit të ujit, rritet dhe përqëndrimi i tyre.

-Jonet klor takohen pothuajse në të gjitha ujërat natyrore dhe përmbajtja e tyre lëviz në shkallë të gjerë. Depozitimet (shtresëzimet) e kriprave klorure, treten në ujë këto, merren nga ujërat nëntokësore dhe lumenjtë dhe dërgohen në dete dhe oqeanet, ku në sajë të qarkullimit, arrijnë përqëndrime të larta.

-Jonet sulfat ashtu si dhe jonet klorure, ndodhen në të gjitha ujërat natyrore. Në ujërat nëntokësore përmbajtja e SO_4^{2-} zakonisht është më e lartë, se sa në ujërat e lumenjve dhe liqeneve. Burimi kryesor i pranisë së joneve sulfat në ujë, janë gipset $\text{CaSO}_4 \cdot 2\text{H}_2\text{O}$.



-Jonet hidrugjen (H^+) dhe hidroksil (OH^-), gjenden në ujë si rezultat i shpërbashkimit :
 $\text{H}_2\text{O} = \text{H}^+ + \text{OH}^-$.

Jonet hidrogjen mund të shfaqen gjithashtu dhe për shkak të shpërbashkimit të acideve, si p.sh: $\text{HCl} = \text{H}^+ + \text{Cl}^-$; ndërsa hidroksilet, si rezultat i disocijimit të alkaleve, si p.sh. : $\text{NaOH} = \text{Na}^+ + \text{OH}^-$.


Në ujin e pastër kimikisht, në temperaturë. 23°C , përqëndrimi i $[\text{H}^+]$ dhe $[\text{OH}^-]$ është 10^{-7} g-jon/l dhe karakterizon reaksionin neutral të ujit. Në mjedis acid $[\text{H}^+] > 10^{-7} > [\text{OH}^-]$, në mjedis bazik $[\text{H}^+] < 10^{-7} < [\text{OH}^-]$. Reaksioni i solucionit zakonisht shprehet me treguesin pH ose pOH, secili prej tyre është- koologaritmi i përqëndrimit korrenspondues të joneve.

Në mjedis neutral $\text{pH} = 7 = \text{pOH}$. Mjedis acid karakterizohet nga mosbarazimi $\text{pH} < 7 < \text{pOH}$, ndërsa ai bazik, nga mosbarazimi $\text{pH} > 7 > \text{pOH}$.

-Acidi karbonik është dy funksional dhe ka dy shkallë shpërbashkimi:



Në ujërat natyrore, përmbajtja e të ashtuquajturit gaz karbonik “i lirë”, ndodhet në të në formë gazi karbonik të tretur CO_2 dhe molekulash të pashpërbashkuara të acidit karbonik H_2CO_3 , përmbahen jone bikarbonati HCO_3^- , dhe në disa raste jone karbonati CO_3^{2-} . Raportet sasiore ndërmjet CO_2 , H_2CO_3 , HCO_3^- dhe CO_3^{2-} , përcaktojnë vlerën e pH të ujit. Raporti i formës së acideve karbonike në ujë në % në 25°C dhe vlerat e ndryshme të pH. Në tretësirat ujore ekziston një ekuilibër kinetik ndërmjet formave të ndryshme të acidit karbonik:



Nga kjo shprehje rrjedh, që për të mbajtur në tretësirë një përqëndrim të caktuar HCO_3^- duhet që në ujë të ndodhet sasia korresponduese e përqëndrimit të CO_2 të lirë “ekuilibri i acidit karbonik”. Në se faktikisht, përmbajtja në ujë e sasisë së gazit karbonik të lirë është më shumë se “ekuilibri i përqëndrimeve”, atëherë teprica e tij do të mundësojë tretjen e CaCO_3 nga kontakti me ujin i gëlqerorëve e dolomiteve. Ky ujë quhet “agresiv”. Ndërsa, në të kundërt, kur përmbajtja e CO_2 është më e vogël sesa ai i ekuilibrit të përqëndrimeve atëhere rritet sasia e joneve bikarbonate. Kjo shkakton formimin e teprices së joneve karbonat CO_3^{2-} , të cilat bashkëveprojnë me kationet e kalciumit, që ndodhen zakonisht në tretje duke formuar karbonat kalciumi i cili ndahet, $\text{Ca}^{2+} + \text{CO}_3^{2-} = \text{CaCO}_3$.

-Komponimet e azotit takohen në ujëra natyrore në formën e joneve të amonit NH_4^+ , joneve nitrite NO_2^- dhe joneve nitrate NO_3^- . Burimi kryesor i shfaqjes së këtyre joneve në ujrat natyrore, vjen nga shpërbërja e lëndëve të përbëra organike shtazore ose bimore. Jonet e amonit, përveç kësaj, mund të kenë prejardhje dhe nga derdhjet (mbeturinat) e ujërave industriale. Në ujërat sipërfaqësore të pandotura, përmbajtja e NH_4^+ është e rendit të të dhjetave të mg/l, ndërsa në ujërat e ndotura ato arrijnë në qindra mg/l. Në prani të sasive të mjaftueshme të oksigjenit dhe të llojeve të veçanta bakteriesh, jonet e amonit oksidohen në nitrite dhe së fundi në jone nitrate. Në këtë mënyrë, NO_2^- dhe NO_3^- janë produkte përfundimtare të një procesi të ndërlikuar mineralizimi të lëndëve organike.

-Komponimet e hekurit takohen në ujërat natyrore në formë dy valente (ferrore) dhe tre valente (ferrike). Këto komponime mund të jenë në gjendje të tretur, në formë koloidale dhe në suspension.

Shumica e ujërave përmbajnë kryesisht në formën e bikarbonatit ferror



$\text{Fe}(\text{HCO}_3)_2$, lehtësisht i hidrolizueshëm dhe i oksidueshëm nga prania në ujë e oksigjenit dhe ulja e përqëndrimit të CO_2 në ujë.

Në ujrat sipërfaqësore hekuri përmbahet kryesisht në formën e komponimeve komplekse organike si dhe në forme të hidroksidit të hekurit $\text{Fe}(\text{OH})_3$. Komponimet komplekse organike të hekurit janë komponimet e hekurit me acidet kimike në ujërat e rrjedhshëm që ushqehen nga moçalet (kënetat). Nga një herë përmbajtja e hekurit në ujëra shkaktohet nga ndotja e tyre prej shkarkimeve industriale. Përqëndrimi i hekurit në ujra mund të rritet për shkak të transportimit të tij në tuba çeliku dhe gize si rezultat i ndotjes së ujit me produkte të korrozionit.

-Komponimet e silicit ndodhen në ujërat natyrore në formë komponimesh me shkallë të ndryshme dispergimi (pjesë koloidale, molekula dhe jone).

Format e shumëllojshme të komponimeve të silicës, shpjegohen nga fakti që silica (SiO₂) ka aftësi të lidhet me sasi të ndryshme molekulash uji, duke formuar acide të ndryshme silicore me formulë të përgjithshme mSiO₂ · nH₂O. Kripat e këtyre acideve formojne një sërë mineralesh, nga tretja e tyre në ujëra natyrore rrjedhin komponimet e silicit me përbërje të ndryshme kimike. Tretshmëria e acideve silicore në ujërat natyrore varet nga një seri faktorësh dhe në rradhë të parë nga përbërja e joneve të ujit dhe vlerat e pH. Prania në ujë e kationeve Ca²⁺ dhe Mg²⁺, që janë të afta të formojnë me acidet silicore, silikate pak të tretshëm, ul mundësinë e koncentrimin të silicit në tretësirë. Ndërsa, prania në ujë e kationeve Na⁺ dhe rritja e vlerës së pH, rrit tretshmërinë e acideve silicore.

Acidi silicor është dy funksional dhe ka dy shkallë shpërbashkimi:



Pjesërisht komponimet e silicit ndodhen në gjendje koloidale në formë pjesëzash të acideve polisilicore mSiO₂ · nH₂O. Nga matjet e ndryshme, rezulton që sasia koloidale e acideve silicore përbën 3 deri 18 % të përmbajtjes së përgjithshme të silicës në ujë. Ndërmjet formave koloidale dhe jonike të acideve silicore ekziston një ekuilibër që varet prej kushteve fizike dhe kimike.

Në ujërat natyrore takohen gjithashtu jonet Al³⁺, Mn²⁺ dhe jone të tjera po kështu në to përmbahet një sasi më e vogël ose më e madhe gazesh N₂, O₂ dhe CO₂, nga sasia e te cilëve kushtëzohet korrozioni dhe agresiviteti i ujrave. Tretshmëria e gazeve në ujë varet nga temperatura e ujit dhe presioni parcial i gazit mbi të. Burimi i pasurimit të ujit natyror me oksigjen është atmosfera, oksigjeni i së cilës absorbohet prej shtresave të sipërme sipërfaqësore të ujit. Përmbajtja e O₂ në ujë rregullohet nga presioni parcial i tij në atmosferë. Nga ana tjetër, oksigjeni në ujërat natyrore hyn në procese të ndryshme oksidimi.


Burimet e pranisë së CO₂ në ujërat natyrore janë proceset e ndryshme biokimike të oksidimit të lëndëve organike si në vetë vendburimin e ujit, ashtu kur ai kalon në tokë, gjatë filtrimit të të cilit, uji pasurohet me CO₂. Mënyrat e thëllësise, shpesh përmbajtja e lartë e sasisë së CO₂ shkaktohet nga reaksionet kimike, lidhen me ndryshimin e përbërjes mineralogjike të tokës. Në pjesën më të madhe gazi karbonik ndodhet në ujë në gjendje molekulare të lirë të tretur në ujë, dhe vetëm një sasi e vogël e tij, vepron me ujin dhe formon acidin karbonik.

Gazi karbonik ndodhet në sasi më të vogël ose më të madhe në të gjitha ujërat natyrore. Vetëm në pH > 8.5 përmbajtja e gazit karbonik të lirë në ujë është praktikisht zero. Përmbajtja e CO₂ në ujërat natyrore mund të zvogëlohet në sajë të lidhjes së gazit karbonik të lidhur me karbonat kalciumi dhe magnezi të gëlqerorëve dhe dolomiteve dhe, së fundi, si rezultat i veprimtarisë jetësore të bimëve ujore.

Fortesia e Ujrave

Uji natyral përmban gjithmone një sasi kripërash të tretura, prej tyre me të rëndësishmet janë kripërat e kalciumit dhe magneziumit të cilat i japin ujit një cilesi të veçantë që quhet fortësi. Uji i Fortë shkakton formimin e cipave (bigore ose smërçe) në muret e kazanëve ngrohës, në enët në të cilat valohet, në kazanët e avullit, ftohësat, etj. Po ashtu produktet ushqimore zjehen me vështirësi prej ujit të fortë, njëkohësisht gjatë larjes me ujë të fortë ai shkumëzon me vështirësi, dhe harxhon më shumë sapun.

Fortësia e ujit është një tregues kryesor për përdorimin e ujit në industri. Në përputhje me kripërat që shoqërojnë ujin dallojmë fortësi karbonate dhe fortësi jo karbonate. Kështu kripërat e tretshme të kalciumit dhe të magneziumit (kryesisht bikarbonatet) përbëjnë fortësinë karbonate. Fortësia karbonate me zjerje zvogëlohet, sepse me ngrohje bikarbonatet zbërthehen:



duke kaluar kështu në precipitat në formë karbonati. Megjithatë një pjesë e fortësisë karbonate mbetet në ujë mbasi këto precipitate kanë produktin e tyre të tretshmërisë, kështu CaCO_3 tretet 0.01 gr/l kurse $\text{Mg}_2\text{CO}_3(\text{OH})_2$ 0.04gr/l. Prandaj gjatë vlimit nuk mund të kalojë në precipitat i gjithë $\text{Mg}(\text{HCO}_3)_2$, rrjedhimisht nuk mund të zhduket plotësisht fortësia karbonate, por ajo vetëm zvogëlohet. Ajo pjesë e fortësisë karbonate që ndahet në formë precipitati gjatë vlimit të ujit quhet fortësi e përkohshme (ose e paqëndrueshme). Fortësia jo karbonate që përbëhet kryesisht nga kriprat e Ca^{++} dhe Mg^{++} në formë kloruresh dhe sasira të pakta sulfatesh, së bashku me pjesën mbetëse të fortësisë karbonate, përbën fortësinë e përhershme (ose e qëndrueshme). Shuma e fortësisë karbonate dhe jo karbonate përbën fortësinë e përgjithshme. Fortësia e ujit matet me gradë fortësi dhe mgr-ekuivalent jone Ca^{++} ose Mg^{++} për H_2O , ose mgr-ekv/ $\text{m}^3 \text{H}_2\text{O}$.

Egzistojnë disa lloj gradësh për matjen e fortësisë së ujit, por më të përdorshmet janë:

1. Gradë gjermane (klark) $1^\circ \text{dH} = 1$ pjesë në peshë CaO në 100000 pjesë në peshë ujë, ose 10 mg CaO në 1 litër H_2O (1 pjesë në peshë MgO është ekuivalent me 1.4 pjesë në peshë CaO) ose shpesh thuhet 1 gr CaO në 100 litra H_2O
2. Gradë Franceze (Boudron-Boude): $1^\circ \text{BB} = 1$ pjesë në peshë CaCO_3 në 100000 pjesë në peshë H_2O ose 10 mg CaCO_3 në 1 litër H_2O (1 gr CaCO_3 në 100 l H_2O)
3. Gradë Angleze $1^\circ = 1$ pjesë në peshë CaCO_3 në 7000 pjesë në peshë H_2O (ose 10 mg CaCO_3 në 0.7 l uje).
4. Gradë Amerikane $1^\circ = 1$ pjesë në peshë CaCO_3 në 10000 pjesë në peshë H_2O ose 1 mg CaCO_3 në 100 l ujë).
5. Miligram – ekuivalent 1mg-ekuiv = 1mg-ekuiv Ca^{++} ose Mg^{++} për 1 lit. ujë = 20.04 mg Ca/l ose 12.156mg Mg/l .

Sipas vleftës së fortësisë ujrave mund të klasifikohen, në ujra:

Shumë të butë, fortësia: 0–1.5mg-ekuiv Ca^{++}/l

Të butë, fortësia: 1.5–3 mg-ekuiv Ca^{++}/l

Me fortësi mesatare, fortësia: 3–4.5mg-ekuiv Ca^{++}/l

Me fortësi të mjaftueshme, fortësia: 4.5–6.5mg-ekuiv Ca^{++}/l

Me fortësi të fortë, fortësia: 6.5–11mg-ekuiv Ca^{++}/l

Shumë të fortë, fortësia: mbi 11mg-ekuiv Ca^{++}/l

Demineralizimi i plote i ujit me anë të procesit të osmozës së anasjelltë

Osmoza inverse është një metodë fizike e demineralizimit të ujit në përgjithësi duke përmbledhur dhe ujin që përdoret në industrinë e birrës.

Në procesin e osmozës, dy solucionet me koncentrimet të ndryshme, të ndarë nga një membranë gjysmëpërshkuese, nën veprimin e presionit osmotik të shkaktuar nga solucioni më i holluar, bënë që të barazohen koncentrimet. Drejtimi i qarkullimit të ujit natyror nëpërmjet një membrane gjysmëpërshkuese të presionit osmotik mund të bëhet invers nëpërmjet aplikimit të një presioni të kundërt me presionin osmotik i cili te jetë më i madh se ky. Në këtë rast uji i pastër, nga solucionet më të koncentruara, difuzion nga poret e membranës në drejtim të ujit të demineralizuar. Ky fenomen emërtohet osmoza inverse. Solucioni me kriperë emërtohet ‘koncentrat’ dhe në të mbesin jonet e ujit dhe substancat organike të ujit, bakteriet, viruset. Uji pa kriperë (demineralizuar) i cili ka kaluar membranën gjysmëpërshkuese emërtohet ‘permeat’. Mbjajtja e joneve varet nga madhësia e joneve dhe e porevetë membranës.

Për rregullimin e alkalinitetit të mbetur në ujërat e trajtuar, është e nevojshme trajtimi i ujit natyral me acide.

Nga membranat ekzistuese që përdoren për demineralizimin e ujit, kanë interes më shumë membranat në formë spirale me rrudha, sepse kanë këto karakteristika pozitive: sipërfaqe të madhe për njësi të volumit (më shumë se 1000 m² membrana /m³).

- fluks të madh uji dhe një mbajtje të madhe kripërash
- humbje të vogël të presionit
- rezistencë ndaj agjentëve kimik shpëlarës
- tolerancë ndaj klorit
- kapacitet më të lartë për të larguar substancat organike
- shfaqje të rralla të difekteve
- rezistencë ndaj presioneve të larta për shkak të substraktit të lartë, poroz, me rezistencë të lartë mekanike dhe sistem drenazhi
- konstrukcion të thjeshtë, të fortë, montohet dhe çmontohet lehtë

Membrana e tipit spiral me rrudha është membranë asimetrike, e ndërtuar nga tre shtresa: një shtresë prej rrjete poliesteri, një mbajtëse e përbërë prej një shtrese mikroporoze e formuar nga polisulfon dhe një shtresë shumë e imët (fine) me trashësi 0.010-0.025 mm zakonisht prej poliamide.

Shtresa prej poliamide e membranës është ngarkuar negativisht, e destinuar për të mbajtur kryesisht anionet. Membrana spirale me rrudha, është ndërtuar nga dy membrana të sheshta të vendosura njëra mbi tjetrën dhe të mbyllura për të formuar një zarf (pliko). Pliku pastaj vendoset përmes një tubi qendror, nëpërmjet të cilit do të qarkullojë uji i demineralizuar (permeati) dhe i cili është mbyllur nga kalimi i ujit të ushqimit, me një zonë neutral, të elementit të osmozës inverse.

Permeati mund të dalë vetëm nëpër rekordet e drenazhit.

Ky konstrukcion formon një element filtrimi. Shumë element filtrues mund të lidhen në seri ose në paralel duke formuar një model filtrimi. Ky montim jep mundësi dhe të heqjes së një elementi të veçantë kur është e nevojshme. Në pasqyrën e mëposhtme është dhënë një klasifikim i membranave tregtare të përdorura për të përgatitur një element filtrimi me membrane tip spirale me rrudha. Për të lehtësuar procesin e çkripëzimit dhe rritjen e produktivitetit të instalimit mund të transformojmë fortësinë karbonate në fortësi sulfate nëpërmjet trajtimit të ujit me acid sulfurik, një pjesë e karbonateve kalon në sulfate. Dioksidi i karbonit i lirë i ujit duhet larguar, dhe për këtë përdoren metoda të ndryshme, si degazim, trajtim me gëlqere ose me shkëmbinj aktiv.

Për stabilizimin e përbërësve të tjerë, të cilët i japin fortësinë e nevojshme ujit të birrës mund të shtohen pas procesit të përpunimit të ujit.

Mundësia e modifikimit të përbërjes së një uji natyral nëpërmjet osmozës inverse është shumë e gjerë. Një impiant për demineralizimin e ujit me osmozë inverse është i përbërë nga pjesët e mëposhtme. Sistemi i paratrajtimit të ujit, instalimi i osmozës inverse, sistemi i kontrollit të çkripëzimit, sistemi i pastrajimit të ujit.

Uji para çkripëzimit pastrohet dhe kondicionohet. Parapastrimi ka si qëllim largimin e substancave koloidale, të substancave suspense me natyrë organike dhe inorganike, hekurin, manganin, substanca të cilat në aparatit e osmozës inverse formojnë depozitime në membranë dhe kanë aftësi të madhe bllokimi të membranave, si rrjedhojë reduktojnë produktivitetin e instalimit. Kondicionimi i ujit natyror konsiston në trajtimin e këtij në dioksid karboni (deri në pH 6.9) ose me acid sulfurik, gjë që bën që një pjesë e bikarbonateve të shndërrohen në sulfate, gjithashtu duke shtuar dhe inhibitor të formimit të koreve (bigorit) p.sh hexameta fosfat (16g/m³).

Nga ky trajtim i kondicionimit, vazhdohet me stabilizimin e disa përbërësve të tretshëm dhe evitimin e precipitimeve të këtyre përbërësve nga uji, dioksidi i karbonit të ujit duhet larguar me anën e ajrimit të ujit.

Instalimi i osmozës inverse përbëhet nga një pompë me presion të lartë dhe modulet e osmozës inverse. Për rritjen e produktivitetit e instalimit uji mund të ngrohet. Është shumë e rëndësishme që ky proces të drejtohet dhe të kontrollohet automatikisht. Kjo mund të realizohet nëpërmjet pajisjes së instalimit me një sistem të mirë monitorizimi të vazhdueshëm për të kontrolluar automatikisht debitin e permeatit, presionin e punës, konduktivitetin dhe temperaturën e ujit. Modifikimi i konduktivitetit të permeatit është një shenjë e qartë e uljes së produktivitetit ose e prishjes së punës të membranave. Pas ç'kripëzimit, uji pa kripë (permeati) mund të modifikohet (të përzihet) sipas kërkesës me ujë natyror të pa ç'kripëzuar. Për të arritur një alkalitet të mbetur të duhur, uji i ç'kripëzuar mund të trajtohet me qumësht gëlqere deri sa të arrijë alkalitetin e duhur. Konsumi i energjisë të ç'kripëzimit të ujit nga osmoza inverse është 1.5-2.0 kwh/m³ permeat.

1. Permbledhje jo-teknike te Raportit te Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis ne nivel kombetare ose nderkombetar kur kerkohet procedura e VNM-es.

Mbeshtetur ne Ligjin Nr.10440, date 07.07.2011 “Per vleresimin e ndikimit ne mjedis”, referuar dhe aktivitetit dhe natyres se veprimtarise se propozuar si dhe pershkrimin:

Shtojca 2: veprimtaria qe ne propozojme perfshihet ne piken 7-Industria ushqimore, prodhimi dhe ambalazhimi i ujit mineral nuk perfshihet ne listen e veprimtrative qe duhet t'i nenshtrohen VNM..

Siç edhe dime Lejet e mjedisit lidhen së pari me operimin e instalimeve dhe kanë fokusim më të ngushtë – kryesisht ndotja mjedisore – shkarkimet në ajër, shkarkimet, mbetjet etj. Qëllimi i aplikimit të lejes së mjedisit është t'i sigurojë autoritetit kompetent informacion duke demonstruar që instalimi i propozuar do të operojë për të reduktuar ndotjen duke përdorur TMD. Leja e mjedisit jepet vetëm kur është rasti. Te lejet e mjedisit, ndikimet mjedisore nuk janë të balancuara përkundrejt kostove të tjera dhe përfitimeve në vendim marrjen.

Ne konkluzion, veprimtaria e propozuar e prodhimit dhe ambalazhimit te ujit nuk kerkon hartimin e Raportit te Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis.

2. Konsultime nderkufitare kur kerkohen sipas legjislacionit ne fuqi

Projekti i propozuar nuk zhvillohet ne zone nderkufitare, ndaj dhe nuk i nenshtrohet konsultimeve nderkufitare.

3. Autoriteti vendimmarres per dhenien e aktit te miratimit te lejes se mjedisit, procedurat dhe afatet qe do te ndiqen

Referuar percaktimit te bere ne piken 1 te kesaj kerkese dhe mbeshtetur ne Ligjin Nr.10488, date 14.07.2011 “Per lejet e Mjedisit”, percaktuam llojin e lejes mjedisore: Leje Mjedisore tipi B.

Mbeshtetur ne Ligjin Nr.10488, date 14.07.2011, nenin 4 – Sistemi i lejeve te mjedisit, pika 1-b, percakton: leja e mjedisit e tipit B është e detyrueshme për kryerjen e veprimtarive të kategorisë B, lista dhe pragjet përkatëse të të cilave janë përcaktuar në shtojcën 1/B të këtij ligji;

pika 2, percakton:

Autoritetet kompetente për lejet e mjedisit të tipave A, B dhe C janë si më poshtë:

- a) **Qendra Kombëtare e Licencimeve (QKL)** është autoriteti ku bëhet kërkesa dhe ku lëshohet leja e mjedisit të tipit A, B dhe C;
- b) **Ministri** është autoriteti që firmos aktin e miratimit të lejeve të mjedisit të tipit A dhe B, pasi ato të shqyrtohen dhe përgatiten nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit;
- c) **Agjencia Kombëtare e Mjedisit** është autoriteti që verifikon saktësinë e informacionit të dhënë nga operatori në kërkesën e tij për leje mjedisi të tipit A dhe B dhe që i jep mendimin e argumentuar ministrit për dhënien ose jo të kësaj lejeje, me kushte të detajuara, të shkruara, të cilat lëshohen nga QKL-ja;

Ne lidhje me procedurat dhe afatet për marrjen e lejes së tipit “B”, duhet t’i referohemi VKM Nr. 419, datë 25.06.2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipit A, B dhe C”.

VKM Nr.419, datë 25.06.2014, Kreu III, – Procedurat për shqyrtimin e kërkesave dhe përcaktimi i kushteve për leje mjedisi të tipit B përcakton procedurën si më poshtë:

1. Kërkuesi që aplikon pranë QKL-së për pajisjen me leje mjedisi të tipit B duhet të dorëzojë këto dokumente:

- a) Formularin informues për pajisje me leje mjedisi të tipit B, sipas shtojcës 2, bashkëlidhur këtij vendimi;
- b) Mandatpagesën për tarifën përkatëse për lejen e mjedisit të tipit B, sipas nenit 25 të ligjit nr.10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”;
- c) Çdo informacion tjetër që kërkuesi i lejes kërkon të merret parasysh gjatë shqyrtimit të aplikimit;
- ç) Kopjen e vendimit të AKM-së për VNM-në paraprake ose kopje të deklaratës së ministrit për VNM-në e thelluar, të shoqëruar me raportin paraprak ose të thelluar të VNM-së, në rastet kur për instalimin është kryer procedura e vlerësimit të ndikimit në mjedis, sipas përcaktimit në ligjin nr. 10440, datë 7.7.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”.
- d) Raportin mbi sigurinë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për parandalimin e rreziqeve nga aksidentet madhore, kur kërkohet.
- dh) Relacionin rreth dëgjësës me publikun, sipas përcaktimit në pikën 13 të kreut VI të këtij vendimi.

2. AKM-ja, brenda 5 (pesë) ditëve pune nga data e marrjes së aplikimit për leje mjedisi të tipit B nga QKLja, dërgon një kopje të aplikimit në institucionet e mëposhtme, të cilët japin mendimin e tyre, me shkrim dhe në formë elektronike, brenda 10 (dhjetë) ditëve pune:

- a) Drejtoritë teknike në Ministrinë e Mjedisit, sipas specifikave të instalimit;
- b) Inspektoratin Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërrave (ISHMPU);
- c) Agjencinë Rajonale të Mjedisit (ARM).

3. Nëse institucionet e përcaktuara në pikën 2, të këtij kreu, nuk shprehen brenda afatit, AKM-ja vijon me procedurën.

4. AKM-ja, brenda 10 (dhjetë) ditëve pune, pas verifikimit për saktësinë e dokumentacionit të aplikimit për lejen e mjedisit të tipit B dhe mbledhjes së mendimeve nga publiku e institucionet e përmendura në pikën 2, të këtij kreu, harton aktin e miratimit/refuzimit për dhënien ose jo të lejes së mjedisit të tipit B, të shoqëruar me argumentet përkatëse, dhe e dërgon tek ministri.

5. Ministri, brenda 5 (pesë) ditëve pune nga data e marrjes, firmos aktin e miratimit/refuzimit të lejes së mjedisit të tipit B ose ia kthen praktikën AKM-së për shtesa apo ndryshime të këtij akti, të shoqëruar me argumentet përkatëse.

6. AKM-ja, brenda afatit të përcaktuar në këtë vendim, publikon vendimin e miratimit ose të refuzimit në Regjistrin Kombëtar të Licencave dhe Lejeve për leje mjedisi të tipit A.

Refereuar pikes 1, dh) te ketij kreu – per te bere te mundur aplikimin per leje mjedisi ne QKL, kerkohet te hartohet relacioni per degjesen me publikun sipas percaktimeve te bere ne piken 13, Kreun VI i ketij vendimi:

13. Kërkuesi, kur aplikon për leje mjedisi të tipi A dhe të tipit B, harton një relacion rreth dëgjësës me publikun dhe palët e interesuara dhe e dorëzon në QKL.

Kreu VI i ketij vendimi, percakton procedurat e indormimit dhe pjesmarres se publikut per aplikimin per leje mjedisi te tipit A dhe B, si me pohste vijon:

1. Kërkuesi, përpara aplikimit në QKL, dërgon në AKM, në njësinë e qeverisjes vendore (NJQV) dhe Agjencinë Rajonale të Mjedisit (ARM) ku do të ketë vendndodhjen instalimi një njoftim, me shkrim dhe në formë elektronike (CD, DVD), për aplikimin që do të kryejë për t'u pajisur me leje mjedisore të tipit A ose B, në të paktën 20 kopje elektronike për secilin institucion.
2. Njoftimi duhet të përmbajë këto të dhëna:
 - a) Informacion nëse kërkesa do të jetë për “Aplikim për leje mjedisi të tipit A ose të tipit B” apo “Aplikim për ndryshim thelbësor në kushtet e lejes së mjedisit të tipit A ose të tipit B”.
 - b) Të dhënat e ekstraktit të QKR-së;
 - c) Adresën e vendndodhjes së instalimit;
 - ç) Përshkrimin e veprimtarisë që parashikohet të zhvillohet në instalim;
 - d) Një përshkrim të elementeve të listuara në formularin informues;
 - dh) Përmbledhjen joteknike të raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis në nivel kombëtar ose ndërkuftar, kur kërkohet procedura e VNM-së;
 - e) Konsultimet ndërkuftare, kur kërkohet sipas legjislacionit në fuqi;
 - ë) Autoritetin vendimmarrës për dhënien e aktit të miratimit të lejes së mjedisit, procedurat dhe afatet që do të ndiqen;
 - f) Adresën e AKM-së, ku publiku mund të dërgojë komentet dhe sugjerimet e tij, me shkrim apo në formë elektronike, brenda 20 (njëzet) ditëve nga data e njoftimit.
3. AKM-ja publikon, në faqen e saj të internetit, njoftimin sipas pikës 2 të këtij kreu, për të paktën 20 (njëzet) ditë kalendarike, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e marrjes së njoftimit.
4. Pas publikimit të njoftimit në faqen e internetit të AKM-së, kërkuesi publikon në, të paktën, një gazetë të zonës ku do të ushtrohet veprimtaria dhe në një gazetë kombëtare njoftimin për aplikimin, duke iu referuar për informacion më të hollësishëm faqes së internetit të AKM-së. Njoftimi publikohet në, të paktën, dy numra të njëpasnjëshëm të secilës gazetë.
5. Njoftimi në gazetë duhet të përmbajë, të paktën:
 - a) llojin e instalimit/veprimtarisë;
 - b) emrin e personit fizik/juridik;
 - c) adresën e vendndodhjes së instalimit;
 - ç) adresën e internetit ku është publikuar njoftimi dhe adresën e AKM-së, ku publiku mund të dërgojë komentet dhe sugjerimet e tij, me shkrim apo në formë elektronike, brenda 20 (njëzet) ditëve nga data e njoftimit.
6. NJQV-ja (bashkia apo komuna), në territorin e së cilës do të jetë vendndodhja e instalimit, pasi merr njoftimin sipas pikës 2, të këtij kreu, e publikon në një vend të dukshëm në mjediset e saj për të paktën 20 (njëzet) ditë.
7. Publiku ka të drejtë të konsultojë në mjediset e NJQV/AKM/ARM dhe të kërkojë një kopje të njoftimit, sipas pikës 2, të këtij kreu, nga NJQV/AKM/ARM, pa pagesë.
8. Publiku mund të bëjë komente, me shkrim ose në mënyrë elektronike, mbi njoftimin për leje mjedisi të tipit A në adresën e AKM-së brenda afatit 20-ditor të publikimit.
9. Në përfundim të afatit 20-ditor, kërkuesi, në bashkëpunim me AKM-në dhe NJQV-në, brenda 25 (njëzet e pesë) ditëve organizon një dëgjësë me publikun dhe palët e interesuara, përfshirë OJF-të.
10. Njoftimi për dëgjësën me publikun shpallet gjatë 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve:
 - a) në radio ose TV dhe gazetën vendore;
 - b) në faqen e internetit të AKM-së dhe NJQV-së;

- c) në tabelën e njoftimeve, në një vend të dukshëm në mjediset e NJQV-së dhe ARM-së së qarkut përkatës.*
- 11. Njoftimi duhet të shoqërohet me:

 - a) llojin e instalimit/veprimtarisë;*
 - b) emrin e personit fizik/juridik;*
 - c) adresën e vendndodhjes së instalimit;*
 - ç) vendin ku gjendet kopja e njoftimit në NJQV-në dhe adresën elektronike të AKM-së ku është publikuar njoftimi.*
 - dh) përcaktimin e vendit, të datës dhe orës së organizimit të dëgjësës me publikun.**
 - 12. Procesverbalit i dëgjësës mbahet nga kërkuesi dhe nënshkruhet nga pjesëmarrësit në dëgjësë. Kopje të procesverbalit u vihen në dispozicion publikut, palëve pjesëmarrës në dëgjësë, NJQV-së dhe AKM-së.*
 - 13. Kërkuesi, kur aplikon për leje mjedisi të tipi A dhe të tipit B, harton një relacion rreth dëgjësës me publikun dhe palët e interesuara dhe e dorëzon në QKL.*
 - 14. Shpenzimet e organizimit të dëgjësës mbulohen nga kërkuesi.*
 - 15. AKM-ja, gjatë hartimit të aktit të miratimit të lejes së mjedisit të tipit A dhe B, merr parasysh çdo koment, informacion, analizë apo mendim të paraqitur nga publiku që vlerësohet i vlefshëm dhe argumenton arsyet kur ato nuk janë marrë parasysh.*
 - 16. AKM-ja, kur e gjykon të arsyeshme, delegon ARM-në e qarkut përkatës për të marrë pjesë në dëgjësën me publikun.*

Ne kuader të kësaj kerkese të sipercituar kemi filluar kete procedure te informimit dhe konsultimit me publikun per veprimtarine e propozuar te prodhimit te pelletit.

- 4.** Adresen e AKM-es ku publiku mund te dergoje komentet dhe sugjerimet e tij, me shkrim apo ne forme elektronike, brenda 20 diteve nga data e njoftimit.

Autoriteti shteteror ku mund te dergohen komentet dhe sugjerimet per sa pershkruhet ne kete kerkese per informim dhe konsultim te publikut eshte:

Agjencia Kombetare e Mjedisit (AKM)

Adresa: Rr. “Sami Frasheri”, Nr.4, Tirane
 Tel & Fax: 04 2 371 237
www.akm.gov.al
 e-mail: info@akm.gov.al